VENDIM
Nr.701, datë 28.9.2011

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALEVE MBI KASKADËN E LUMIT OSUM, SI PROPOZIM I KËRKUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, 9 e 16 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentraleve mbi kaskadën e lumit Osum, si propozim i kërkuar, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha